

KONTRATE DHURIMI KUOTASH

Sot më datë 19/05/2021 (dymijë e njëzetë e një) në Tiranë, palët si më poshtë:

PALA DHURUESE:

YOUSEF ALANSARI, atesia Yaqoub, shtetas i Kuvaitit, lindur ne Kuvait, me 09.03.1984, mbajtes i Pasaportes me Nr 003527408, rezident ne Kuvait, madhor me zotesi te plote per te vepruar .ne cilesine e ortakut te 1 kuote me pjesemarrje ne perqindje 20 % te kapitalit themeltar te **Shoqërise "GULF PRODUCTIONS" shpk. në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Dhuruesi";**

FAHAD MOHAMMAD, atesia Salem, shtetas i Kuvaitit, lindur ne Kuvait, me 28.06.1982, mbajtes i Pasaportes me Nr.0042755888, madhor me zotesi te plote per te vepruar .ne cilesine e ortakut te 1 kuote me pjesemarrje ne perqindje 20 % te kapitalit themeltar te **Shoqërise "GULF PRODUCTIONS" shpk. në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Dhuruesi";**

SAUD ALOUN, atesia Sulaiman, shtetas i Kuvaitit, lindur ne Kuvait, me 27.03.1985 mbajtes i Pasaportes me Nr P05009047, rezident ne Kuvait, madhor me zotesi te plote per te vepruar .ne cilesine e ortakut te 1 kuote me pjesemarrje ne perqindje 20 % te kapitalit themeltar te **Shoqërise "GULF PRODUCTIONS" shpk. në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Dhuruesi";**

AHMED MAHMOUD ELAZAB, atesia Aly, shtetasi Egjiptian, lindur ne Kairo, me 05.03.1979, mbajtes i Pasaportes me Nr A11233749, rezident ne Kairo, madhor me zotesi te plote per te vepruar .ne cilesine e ortakut te 1 kuote me pjesemarrje ne perqindje 20 % te kapitalit themeltar te **Shoqërise "GULF PRODUCTIONS" shpk. në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Dhuruesi";**


PALA PRANUESE E DHURIMIT:

OMID KARIMI, lindur me 10.07.1983, ne Teheran, shtetas Afgan, banues ne Tirane, indetifikuar me Pasaporte nr. OA1411685, madhor me zotesi te plote per te vepruar , pajisur me leje qendrimi shqiptare nr.3760, njohes i gjuhes shqipe (në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Pranues i Dhurimit";

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Dhuruesi dhe Pranuesi i dhurimit do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

Kushtet paraprake

- A) Dhuruesi **YOUSEF ALANSARI** është ortak dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 20% (njëzet përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë të së drejtës shqiptare "GULF PRODUCTIONS" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, NUIS L62221018T , me seli në TIRANE Rruga "Pese Maji", Vila L, Shkalla 1, Ap.26 (në vijim referuar edhe si "Shoqëria"), dhuruesi **FAHAD MOHAMMAD** është ortak dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 20% (njëzet përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë të së drejtës shqiptare "GULF PRODUCTIONS" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, NUIS L62221018T , me seli në TIRANE Rruga "Pese Maji", Vila L, Shkalla 1, Ap.26 (në vijim referuar edhe si "Shoqëria"), dhuruesi **SAUD ALOUN** është ortak dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 20% (njëzet përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë të së drejtës shqiptare "GULF PRODUCTIONS" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, NUIS L62221018T , me seli në TIRANE Rruga "Pese Maji", Vila L, Shkalla 1, Ap.26 (në vijim referuar edhe si "Shoqëria"), dhuruesi **AHMED MAHMOUD ELAZAB** është ortak dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 20% (njëzet përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë të së drejtës shqiptare "GULF PRODUCTIONS" Sh.p.k, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar pranë Qendrës



Kombëtare të Biznesit, NUIS L62221018T , me seli në TIRANE Rruga "Pese Maji", Vila L, Shkalla 1, Ap.26 (në vijim referuar edhe si "Shoqëria"),

- B) Pranuesi i dhurimit është ortak dhe zotëron 1 (një) kuote të barabartë me 20% (njëzet përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
- C) Dhuruesit dëshirojnë t'i dhurojnë pranuesit te dhurimit 4 (katër) kuota te barabartë me 80% (tetedhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë,
- D) Pranuesi i Dhurimit deklaron se e pranon dhurimin e 4 (katër) kuotave të barabarta me 80% të kapitalit themeltar te shoqerise "GULF PRODUCTIONS" Sh.p.k.
- E) Palët deklarojnë dhe pranojnë shprehimisht se përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, të gjithë ortakët e Shoqërisë janë njoftuar për dhurimin e kuotes.
- F) Më datë 19/05/2021 përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate dhurimi, asambleja e përgjithshme e Shoqërisë, ka miratuar transferimin e Kuotës.

ATËHERË, duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, palet bihen dakort sa më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj Kontrate është dhurimi i 4(kater) kuotave ne pjesemarrje ne perqindje 80 % (tetedhjetë përqind) te kapitalit themeltar te Shoqërisë "GULF PRODUCTIONS" shpk qe zoterojne ortakët z. YOUSEF ALANSARI, FAHAD MOHAMMAD, SAUD ALOUN, AHMED MAHMOUD ELAZAB,Pranuesit te dhurimit z. Omid Karimi.

Neni 2

Dhurimi i kuotës

- 2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, dhuruesit dëshirojnë t'i dhurojnë pranuesit te dhurimit kuotat qe ata zoterojne ne shoqerine "GULF PRODUCTIONS" SHPK, të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të pranuesit te dhurimit i cili deklaron se e pranon kuoten.
- 2.2. Dhurimi dhe transferimi i titullit te kuotes behet me nenshkrimin e kesaj kontrate dhe dorezimin e kuotave tek pranuesi i dhurimit i cili merr persiper te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Dhuruesit dhe ne veçanti te drejten per te marre pjese ne fitimet e shoqerise, per te ndare pasurine e shoqerise si dhe merr persiper detyrimet dhe pasivet e mundeshme.
- 2.3. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, struktura e zotërimit te kapitalit te Shoqërisë "GULF PRODUCTIONS" SHPK do te jete:
 - 1. **OMID KARIMI** zotërues i 1 (nje) kuote ne pjesemarrje ne perqindje 100 % te kapitalit themeltar te Shoqërisë "GULF PRODUCTIONS" shpk

Neni 3

Deklarime dhe Garanci të Dhuruesit

- 3.1 Dhuruesi garanton pranuesin e dhurimit se është personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.
- 3.2 Dhuruesi garanton pranuesin e dhurimit se Kuota objekt i kësaj Kontrate, është e lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve.
- 3.3 Pranuesi i dhurimit deklaron se pranon dhurimit e kuotes te dhuruesit sipas gjendjes së faktit dhe të së drejtës në të cilën ajo ndodhet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 3.4 Dhuruesit me nenshkrimin e kesaj kontrates nuk kane dhe nuk do te kene asnje pretendim ne lidhje me 4 (kuotat) e barazvlefshme me 80% (tetedhjetë perqind) te kapitalit themeltar te shoqerise "GULF PRODUCTIONS" qe ata zoteronin, dhe pronar i

Ahmed Azab

vetem dhe legjitim pa asnje barre dhe detyrim ndaj te treteve behet pranuesi i dhurimit z. OMID KARIMI.

3.5 Kjo kontrate do te jete e detyrueshme dhe do te kete pasoja juridike ndaj paleve, trashegimtareve te tyre, si dhe ndaj atyre te cileve iu eshte ceduar ne menyre te rregullt,

Neni 4

Shpenzimet dhe taksat

4.1 Shpenzimet ligjore dhe taksat, shpenzimet noteriale, tarifat e regjistrimit në zyrat kompetente si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë Kontratë, do të jenë në ngarkim të pranuesit të dhurimit

4.2 Shpenzimet e tjera do te paguhen nga palet sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 5-Interpretimi i kontratës

Kushtet e përcaktuara në këtë kontratë interpretohen pa u ndalur në kuptimin letrar të fjalëve, por duke pasur parasysh qëllimin e vërtetë të palëve, që i ka shtyrë për nënshkrimin e këtij akti. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saja interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.

Nese pjese te kesaj kontrate jane ose behen te pavlefshme ose jodetyruese, palet do te jene te detyruara te zbatojne pjesen tjetere te kontrates, Ne kete rast, palet do te zvendesojne pjesen e pavlefshme ose jo detyruese me parashikime te vlefshme e detyruese efektet e te cilave sipas permbajtjes dhe qellimeve te kesaj kontrate duhet te jene ne kufijte e te mundshmes, e ngjashme me pjesen e pavlefshme ose jodetyruese.

NENI 6- Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të shfaqen, direkt ose indirekt, midis palëve kontraktuese në lidhje me interpretimin, ekzekutimin, zgjidhjen apo vlefshmërinë e kësaj kontrate palët paraprakisht duhet të diskutojnë në lidhje me këto mosmarrëveshje për zgjidhjen e tyre me mirëkuptim. Nëse nuk arrihet një marrëveshje sipas parashikimeve të bëra në këtë nen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kompetente është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 7

LIGJI I ZBATUESHËM

Kjo Kontrate rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Paleve.

Neni 8

Përmbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet


Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve në lidhje me transferimin e 1 (nje) kuote e barazvlefshme me 60 % (gjashtedhete perqind) te kapitalit themltar qe zoteron dhuruesi, tek pranuesi i dhurimit dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo deklaratimet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

Neni 9

Aneksat e kontrates

Kesaj kontrate i bashkengjiten si pjese perberese dhe te pandara keto dokumenta qe do te quhen Aneksa te kontrates. Pjesë përbërëse të kësaj kontrate është dhe dokumentacioni bashkangjitur:

- Ekstrakti i Regjistrimit Tregetar
- Kopje teleternjoftimeve te personave nenshkrues
- Vendimi i Asamblese se Pergjithshme.



PALET KONTRAKTUESE
Lexuar, aprovuar dhe nënshkruar nga:


PALA DHURUESE
YOUSEF ALANSARI

YUSEF ALANSARI



FAHAD MOHAMMAD

Fahad Mohammad




SAUD ALOUN

Saud Aloun

AHMED MAHMOUD ELAZAB

Ahmed Mahmoud Ahmed Arab

ELAZAB



PALA PRANUESE E DHURIMIT
OMID KARIMI

